



<https://edufootprint.interreg-med.eu>

## EduFootprint

Ulja e sasisë së gjurmëve të karbonit në shkollat  
e qyteteve Mesdhetare

Newsletter #1  
Mars 2017

Në këtë numër...

**Mirë se vini në EduFootprint: Përmbledhje e projektit  
Përditësime mbi projektin EduFootprint**

- Takimi lançues në Treviso
- Kalkulatori EduFootprint
- Aktivitetet dhe eventet e ardhshme: si mund të bëheni pjesë?

**Ndërtesat Efiçente të Komunitetit MED**

**Konsorcium**

**Detajet e kontaktit të projektit**

**Interreg**  
Mediterranean



Project co-financed by the European  
Regional Development Fund



**EduFootprint**



## Mirë se vini në EDUFOOTPRINT

EduFootprint është një projekt modular (M2) Interreg MED i bashkë-financuar nga Fondi Europian i Zhvillimit Rajonal. Synimi i tij është ngritja e kapaciteteve të pronarëve dhe menaxherëve të ndërtesave publike për një menaxhimin më të mirë të energjisë; që do të arrihet jo vetëm duke konsideruar impaktin energjik të drejtëpërdrejtë të ndërtesave (konsumi), por gjithashtu dhe atë indirekt (prokurimet publike ose ndërgjegjësimi dhe sjellja e përgjithshme). Duke filluar nga 1 Nëntor 2016, aktivitetet e tij do të fokusohen në testimin dhe transferimin e një strategjie të integruar energjitike me një qasje të Ciklit të Vlerësimit Jetësor (LCA) në shkolla, e cila konsiston në elaborimin dhe zbatimin e praktikave të efikasitë energjike të integruara me Plane Veprimi vendore të Energjisë së Qëndrueshme (SEAPS).

Veprimi transnacional është jetësor sepse projekti do të testojë modelin EduFootprint në shumë vende të ndryshme MED dhe do të diseminojë zgjidhjet inovative, të cilat përfshijnë pronarët dhe autoritetet publike, sektorin privat dhe përdoruesit final në shtatë rajonet MED. Zonat me më pak eksperiencë kanë mundësinë të veprojnë mbi baza të sprovuara nga dijet ekzistuese të partnerëve të tjerë dhe modeli do të testohet në vende të ndryshme me mënyra të ndryshme në menaxhimin e ndërtesave publike.

Projekti do të lejojë reduktimin e kostove të energjisë për ndërtesat publike në zonat MED. Përdorimi i një qasje e cila merr në konsideratë shkollën në të gjithë ciklin e saj jetësor, siguron një efekt shumëfishues të veprimeve, pra një stil jetese qytetari me sasi karboni të reduktuar, si dhe rritje dhe promovim të zgjidhjeve eco-inovative, edukative dhe kulturore për grupet e ndryshme të interesit (studentët, familjet e tyre, mësuesit, institucionet publike, furnizuesit e shërbimeve energjitike).



## Përditësime mbi projektin EDUFOOTPRINT

### Takimi lançues i EDUFOOTPRINT në Treviso

Lançimi i projektit EduFootprint u zhvillua në 30 Nëntor dhe 1 Dhjetor 2016, në zyrat qendrore të Partnerit Udhëheqës (Provinca e Trevisos), në Treviso. Ky takim u lejoi partnerëve të njihen më mirë me njëri tjetrin dhe të diskutojnë çështjet kryesore mbi fillimin konkret të procedurave dhe strukturës së menaxhimit të projektit.

Takimi ishte gjithashtu edhe një rast për ndarjen dhe planifikimin e punës teknike të paketave të punës dhe aktiviteteve komunikuese. Konsorciumi u mbështet në praninë e përfaqësuesve të projektit horizontal MEDNICE, lider të projektit MED "Ndërtesat Efiçente", të cilët prezantuan projektin dhe komunitetin të të gjithë partnerët dhe shpjeguan misionin e tyre, aktivitetet kryesore të parashikuara dhe përfitimin e pritshëm dypalësh për të gjithë anëtarët e komunitetit "Ndërtesat Efiçente".





## Kalkulatori EduFootprint: instrumenti kryesor i projektit është gati

Ambiente Italia, partner në projektin EduFootprint, ka zhvilluar një instrument i cili lejon përlllogaritjen automatike të gjurmës mjedisore në shkolla: Kalkulatori EduFootprint.

Kalkulatori mat konsumin e burimit dhe aktivitetet e ndërmarra në shkolla dhe i konverton në impakt mjedisor si pasojë e furnizimit të burimeve dhe asimilimin e mbetjeve të gjeneruara. Mund të ndihmojë pronarët dhe menaxherët e shkollave për të identifikuar impaktin kryesor mjedisor të aktiviteteve të përditshme dhe të inkurajojë progresin drejt praktikave të qëndrueshme. Kalkulatori merr në konsideratë jo vetëm konsumin e drejtëpërdrejtë të ndërtesës (si për shembull energjia dhe uji), por edhe aktivitete të tjera që kanë ndikim mbi mjedisin, lidhur me shkollën, si lëvizshmëria (nga shtëpia në shkollë, por edhe udhëtimet edukative dhe eskursionet).

Kalkulatori EduFootprint është një dokument excel me fletapune të ndryshme, kryesorja është Hedhja e të Dhënave, e cila plotësohet me të dhënat e mbledhura nga shkollat, e ndarë në pesë grupe:

- ▶ Konsumi i ndërtesës (energja elektrike, termale dhe konsumi i ujit)
- ▶ Konsumi i produktit (produkteve të letrës, produktet e tualeteve dhe pastrimit, pajisjet, materialet kimike në laboratore, kopshtaria)
- ▶ Lëvizshmëria (mjetet e brendshme, lëvizjet shtëpi-shkollë, eskursionet)
- ▶ Ushqimi (menza, kafeteria, pajisjet larëse)
- ▶ Mbetjet (mbetjet, mbetjet ujore)



Këto të dhëna lejojnë gjenerimin automatik të impaktit të shkollave, duke përdorur metodologjinë Vlerësimi Ciklik i Jetës, duke konsideruar të gjithë ciklin jetësor të aktiviteteve edukative, shprehur si Gjurma Mjedisore në shkolla.



Versioni i parë i kalkulatorit u shpërnda, së brendshmi, në Shkurt dhe të gjithë partnerët u trajnuan sesi ta përdorin atë. Gjatë një periudhë 6 javore, u zhvillua një test për të korrigjuar disa elemente dhe për të patur versionin përfundimtar 00, i cili po përdoret në fazën e parë të projektit me punën në grupe pilote.

---

## Aktivitetet dhe eventet e radhës: si mund të përfshihesh?

Aktivitetet në vijim janë planifikuar për 6 mujorin e ardhshëm:

- Bashkëpunimi me shkollat e përzgjedhura në rajonet e ndryshme pjesëmarrëse për të përlogaritur Gjurmën e tyre mjedisore dhe fushat e përmirësimit
- Bashkëpunimi me autoritetet vendore përgjegjëse për shkollat dhe universitetet publike dhe menaxherët e energjisë
- Performimi i workshopeve rajonale ndërgjegjësuere të Komunitetit të Ndërtesave MED
- Aktivitete ndërgjegjësuere



- Dëshiron të dish më shumë rreth projektit?
- Mendon se shkolla juaj duhet të ketë interes të dijë gjurmën e saj mjedisore?
- Jeni administratë publike e interesuar ose përgjegjës për menaxhimin e energjisë dhe çështjeve mjedisore në ndërtesat publike?
- Mendon se ndryshimi është i mundur?

*Na kontaktoni dhe bashkohuni me EduFootprint në Twitter (@EduFootprint)!*



## Komuniteti MED i Ndërtesave Efiçente

Për periudhën 2014-2020 të programit Interreg MED, është adoptuar një qasje e re për menaxhimin e projektit që sjell orientimin në identitetin e projekteve dhe rezultatet (e pritshme) më shumë sesa në procesin ose outputet e thjeshta.

Në këtë kontekst, komunitetet tematike të projekteve MED janë krijuar për të mundësuar një qasje të integruar të strategjive tematike të programit, duke favorizuar rrjetin dhe sinergjinë midis projekteve të financuara, si dhe qasjen e integruar të komunikimit të objektivave të programit.

Secili projekt modular është pjesë e një komuniteti tematik projektesh, që zgjasin përgjatë periudhës së programit të cili do të kontribuojnë. EduFootprint është një nga dhjetë projektet modulare, që merret me efiçencën e energjisë në ndërtesat publike, pjesë e komunitetit tematik Ndërtesat Efiçente.



Ky komunitet tematik është i koordinuar nga projekti horizontal MEDNICE (rrjeti i programeve MED për një Bashkëpunim Inovativ në Efiçencën energjitike). Ky komunitet është çadra e projekteve të mëposhtme modulare: EDU-FOOTPRINT, TEESCHOOL, STEPPING, SISMA, SHERPA, PRIORITEE, NEË FINANCE, IMPULSE, ENERJ dhe CESBA MED.

### MEDNICE takimi lançues



Takimi lançues i projektit horizontal MEDNICE u mbajt nga 7 deri më 8 Mars, në Nice (Francë), ku ishin ftuar të gjitha projektet modulare të asociuara në komunitetin MED Ndërtesat Efiçente.

Ditës së parë u fokusua te partnerët e MEDNICE dhe Sekretariatit e Përbashkët MEDNICE. Më pas, të gjitha projektet modulare të asociuara në komunitetin MED Ndërtesat Efiçente u mblodhën dhe formuan një vendtakim ekselent për fillimin e një bashkëpunimi midis

tyre. Gjatë ditës së dytë, përfaqësues të SME-ve, biznese dhe grupeve të lobimit patën mundësinë të merrnin pjesë në event, në kërkim të sinergjive të mëtejshme si në projektet modulare ashtu dhe horizontale, duke kontribuar në lançimin e komunitetit tematik Ndërtesat Efiçente.



# Konsorciumi

## Partneri udhëheqës



### PROVINCE OF TREVISO

E-mail: [europa@provincia.treviso.it](mailto:europa@provincia.treviso.it)  
Tel.: +39 0422 656902  
Faqja web : <http://www.provincia.treviso.it/>

@provtreviso



### REGIONAL ENERGY AND ENVIRONMENT AGENCY FROM NORTH ALENTEJO

E-mail : [ana.lacao@areanatejo.pt](mailto:ana.lacao@areanatejo.pt)  
Tel. : +351 245309084  
Faqja web: <http://www.areanatejo.pt>

@AREANATEjo



### INSTITUTE FOR INNOVATION AND DEVELOPMENT OF UNIVERSITY OF LJUBLJANA

E-mail : [andreja.burkeljca@iri.uni-lj.si](mailto:andreja.burkeljca@iri.uni-lj.si)  
Tel. : +386 40416129  
Faqja web: <http://iri.uni-lj.si>



### EUROMEDITERRANEAN CENTRE FOR SUSTAINABLE DEVELOPMENT

E-mail : [e.arrabito@svimed.eu](mailto:e.arrabito@svimed.eu)  
Tel. : +39 3466 441286  
Faqja web: <http://www.svimed.eu>

@svimed



### EUROPEAN INSTITUTE PASHKO

E-mail : [kebjana.haka@uet.edu.al](mailto:kebjana.haka@uet.edu.al)  
Tel. : +355 698593601  
Faqja web: <http://www.uetcentre.org>

@Instituti-European-Pashko



### EGTC EFXINI POLI – SOLIDARCITY NETWORK

E-mail : [epolis@efxini.gr](mailto:epolis@efxini.gr)  
Tel. : +30 2102486041  
Faqja web: <http://www.efxini.gr>

@eoes.efxini.poli



Innovation and Technology

### ANDALUSIAN INSTITUTE OF TECHNOLOGY

E-mail: [edufootprint@iat.es](mailto:edufootprint@iat.es)  
Tel.: +34 954 468 010  
Faqja web: <http://www.iat.es>

@IAT



### AMBIENTE ITALIA SRL

E-mail : [roberto.cariani@ambienteitalia.it](mailto:roberto.cariani@ambienteitalia.it)  
Tel. : +39 0422 445208  
Faqja web: <http://www.ambienteitalia.it>

@AI\_AIP @ambienteitsrl



### RETE ISIDE, SCHOOLNET FOR ENVIRONMENT AND ENERGY SAVING

E-mail : [galpigi@gmail.com](mailto:galpigi@gmail.com)  
Tel. : +39 3317475600  
Faqja web: <http://www.reteideambiente.it>



## Detajet e kontaktit të projektit

### Kontakt i përgjithshëm:

E-mail : [edufootprint@gmail.com](mailto:edufootprint@gmail.com)

Tel. : +39 0422 656902

Faqja Web : <https://edufootprint.interreg-med.eu>



@EduFootprint

